



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 5/2 Prot.

Tiranë, më 08/3/2011

Lënda: Rekomandim për **Shkollën e Mesme të Përgjithshme, Gjimnazi "Ismail Qemali"**.

REKOMANDIM

Nr. 5/2, datë 08/03/2011

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Shkolla e Mesme e Përgjithshme, Gjimnazi "Ismail Qemali"**,

KONSTATOVA

Më datë 07/02/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Shkolla e Mesme e Përgjithshme, Gjimnazi "Ismail Qemali"**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive të parashikuara në nenet 5,6,7 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".
- A përpunohen e transmetohen të dhëna për qëllime statistikore, gazetarie e literature? Nëse zbatohen kriteret e parashikuara në nenet 10 e 11 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*".
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.

- Siguria e të dhënave personale, kategoria e mjeteve të përpunimit që përdoren, masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27)
- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).
- Nëse ka instalime të kamerave (CCTV), si ato përdoren dhe a ka tabela informuese për përdorimin e tyre.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi materialet e kontrollit administrativ, (proces-verbalin e konstatimit të shkeljeve, relacionin etj.) si dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi, Gjinnazi “Ismail Qemali”, nuk ka plotësuar në formularin e njoftimit rubrikën “katëgoria e të dhënave personale që përpunohen” dhe nënrubrikat “Adresa”, “Fotot”.
 - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë” dhe 23 të ligjit “Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor”.
2. Kontrolluesi, Gjinnazi “Ismail Qemali”, nuk është shprehur në rregulloren e brendshme të hartuar prej tij në lidhje me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.
 - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 “c” i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “.....Udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave “. dhe neni 28 i ligjit, “Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit”.
3. Ky kontrollues përpunon të dhëna nëpërmjet sistemit të vëzhgimit CCTV. Ambientet e tij ishin të pajisura me një sistem kamera vëzhgimi. Ky sistem ishte siguruar vullnetarisht nga vetë prindërit përfaqësuar nëpërmjet Këshillit të Prindërve, i cili ligjërohet nga “Rregullorja e Brendshme e Shkollës”. Nga verifikimi i kryer rezultoi se sistemi funksiononte në korridoret e katit të I, II, III, dhe jo brenda klasave.

Tabelat informuese ishin vendosur në ambientet e shkollës, konform dhe në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”,... “Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informoje subjektin e këtyre të dhënave...”

Akses në kompjuterin ku mbaheshin regjistrimet kishte vetëm Drejtoresha e shkollës dhe një prej anëtarëve të Këshillit të Prindërve, me profesion informaticien. Akses në këtë kompjuter nuk ishte i mbrojtur me passëord, por programi i kamerave kishte të vendosur një passëord që nuk lejonte ndryshimin e opsioneve të tij. Në Hard-diskun e këtij kompjuteri gjendeshin regjistrime jo të përditshme të këtyre kamerave që prej muajit Tetor të vitit 2010 . Frekuenca më e madhe e regjistrimeve të ruajtura ishte në ditet e muajit Janar të vitit 2011, në 3 ose 4 javët e fundit.

Regjistrimet nuk fshiheshin automatikisht por mund të fshiheshin në mënyrë manuale nga hard-disku kompjuterit ku ruheshin. Fshirja e regjistrimeve të kaluara mund të bëhej kur mos kishte më hapësirë të lirë ne hard-disk për vazhdimin e regjistrimeve.

Pavaresisht nga sa më sipër, ky kontrollues nuk kishte një dokument të shkruar ligjor (ose rregullore) që të përcaktonte aksesin e kufizuar të pesonave të lartpërmendur.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 27/2 “ç” i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “.....ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar”

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi, Shkolla e Mesme e Përgjithshme, Gjimnazi “Ismail Qemali”, duhet të plotësojë në Formularin e njoftimit rubrikën “katëgoria e të dhënave personale që përpunohen” dhe nënrubrikat “Adresa”, “Fotot”.
2. Në zbatim të neneve 3, 27 dhe 28 te ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” , ky kontrollues të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregullore seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

Të zbatohen parashikimet e Udhëzimit Nr. 3, datë 05.03.2010, "Mbi Sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme", të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

